



---

**VENDIM**

**Nr. 105 Datë 28 .12.2009**

**MBI ANKIMIN E OSSH SH.A PER VENDIMET E BORDIT TE  
KOMISIONEREVE NR.98 DATE 15.12.2009 DHE NR.100, DATE  
15.12.2009**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2009, mbasi analizoi kërkesën e OSSH sh.a per ankimin e vendimeve te ERE-s nr.98 dhe nr.100, date 15.12.2009, të dërguara nga OSSH sh.a me datë 18.12.2009, dhe relacionin e Grupit te Punes se ERE-s për kete çështje,

**Konstaton se:**

- Argumentat e OSSH sh.a te derguara në kërkesën e saj te dates 18.12.2009, jane riformulime te argumentave dhe shpjegimeve te paraqitura gjate seancave teknike te zhvilluara nga ERE te cilat jane marre ne analize gjate procesit te percaktimit te tarifave dhe çmimeve nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s me shumicen e votave te anetareve te tij

**Vendosi :**

1. Të mos marrë parasysh në cilësinë e provave të reja argumentat e paraqitura ne Ankesen e OSSH sh.a te dates 18.12.2009 ne lidhje me Vendimet e Bordit te Komisionereve nr.98, date 15.12.2009 dhe nr.100, date 15.12.2009.

2. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.98, datë 15.12.2009 “Për percaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2010“,

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



- 
- 3 Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve dhe Nr.100, datë 15.12. 2009 “Për percaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar 2010 -31 dhjetor 2010.
- 4 Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**BUJAR NEPRAVISHTA**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE**  
Bordi i Komisionereve



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

***VENDIMIN***

*Nr. \_\_ Datë 28 .12.2009*

**MBI ANKIMIN E OSSH SH.A PER VENDIMET E BORDIT TE  
KOMISIONEREVE NR.98 DATE 15.12.2009 DHE NR.100, DATE  
15.12.2009**

**Anëtarët e Bordit**

Pro

Kundër

**Bujar Nepravishta**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Entela Shehaj**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Ardian Haçi**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Abaz Aliko**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Shkëlqim Bozgo**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_